Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**11.01.2024**	**22.01.2024**	**2024/0033**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.01.2024, OE "NIKA PrO- Ing SH.P.K.", ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0033, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE " R&Rukolli ", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Punimi i kolektorit per ujera te zeza dhe atmosferike" me nr. të prokurimit: "612-23-11083-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 1,926,498.75 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 13.10.2023;data e hapjes së ofertës: 23.11.2023, date e njoftimit mbi vendimin e AK-se: 18.12.2023 data e njoftimit me letër standarde: 18.12.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		1.Përstatshmëra e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	**1.Deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit.**
		2. Vertetimi nga ATK-ja .	**2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës -kopje)**
		3. Vertetimi nga Gjykata.	**3.Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit jo me te vjeter se 6 (gjashtë) muaj**

			nga data e fundit te dorezimit te tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës- origjinali ose kopje e noterizuar)
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **1.Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e juaj të themelimit me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend – kopja e numrit unik identifikues ose çertifikatës së biznesit.**
		2.Çertifikata e regjistrimit për TVSH	**2. Kopja e çertifikates se regjistrimit për TVSH (deklarues)**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjate tri (3) viteve të fundit duhet te jete min 3,852,997.50 Euro . Në rast të grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar te qarkullimit vjetor per tri vitet e fundit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo ndonje banke e licencuar e Kosoves me bilanc pozitivë qe dëshmon qarkullimin financiar për tri vitet e fundit jo me pak se 3,852,997.50 euro.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 2,889,748.12 euro. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar pune te natyres se ngjajshme.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**
		2.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 15 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min. 10 punetore. Ne kuader te stafit profesional OE duhet ti kete a) Min nje inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise drejtimi Konstruktiv sistemi 5 vjeqar apo masteri (min 5 vite përovoj	**2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE . Per inzhinjeret ne pozicionin a,b,c,d,e duhet te ofrojne diplomën mbi kualifikimin e noterizuar se paku ne 3 mujorin e fundit para njoftimit per kontrate ,kontrata e punes me punedhenesin ose marreveshja mbi angazhim ne kete projekt -CV (te nenshkruar nga vet pala) -leterreference per punet e mepareshme**

		pune pas diplomimit) te jete edhe menaxher i projektit dhe te jete i certifikuar per menaxhim kantieri b) Min nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi infrastrukturë rrugore, sistemi 5 vjeqar ose master (min. 5 vjet provojë pune pas diplomimit) , c) Min nje Inxhinier i diplomuar i Komunikacionit, sistemi 5 vjeqar apo master (min. 5 vjet provojë pune pas diplomimit). d) Min nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik sistemi 5 vjeqar ose master (min. 3 vjet provojë pune nga diplomimi i trajnuar dhe çertifikuar per isntalimin e gypave dhe sigurin e kanalit), e) Min nje Gjeodet bachelor apo master i diplomuar dhe i licencuar (min. 3 vjet pervoj pune pas diplomimit) te jete i certifikuar per menaxhim kantieri.	**ne lemin e kerkuar e leshuar nga punedhenesit, nje deklarate me shkrim ose vendim per cektimin e menaxherit te projektit dhe udheheqesit te punishtes - duhet te dorezohet ne origjinal i nenshkruar dhe vulosur nga OE.**
		3.OE duhet të posedoje paisje teknike të nevojshme per kete projekt 1) Eskavator min 10 ton, (min 3 copë), 2) Eskavator min 5 ton, (min 2 cope), 3) Greider, (min 1 cope), 4) Cilinder per ngjeshjen min 20 ton, (min 1 cope), 5) Cilinder per ngjeshjen min 10 ton, (min 2 cope), 6) Eskavator me çekan min 8 ton, (min 1 copë),7) Prerese per beton dhe asfalt (min 1 cope), 8) Luge ngarkuese min 4 ton, (min 2 copë), 9) Rimorkio per barjte te makinerise (min 1 copë), 10) Autom Mikser vetngrakues per prodhim te betonit (min 1 copë), 11) Gjysme rimorkio Kompresor min 1.5 ton, (min 1 copë), 12) Kamion kiper me peshe bartese min 10 ton, (min 5 copë)	**3.Një listë të mjeteve apo paisjeve teknike qe janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontraten në fjalë- paisjet dhe makineria në dispozicion duhet të deshmohen me kopje të librezave mbi pronsin e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të dorzohen në kopje të qarte dhe të lexueshme.**
		4.Operatori Ekonomik duhet te kete Bazë per beton nga nje kompani e licencuar ose	**4.Licenca apo leja e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale kopje ose marrveshje per furnizim me OE e licencuar te jete origjinal ose e noterizuar nga orgjinali dhe**

		marreveshje per furnizim.	**per kete projekt).**
		5. OE duhet te ofroj Certifikaten ISO 9001 2015	**5.ISO 9001 2015 mbi sistemin e menaxhimit te cilesis - kopje me validitet**
		6. OE duhet te ofroj certifikaten ISO 45001 2018	**6.ISO 45001 2018 sistemi per menaxhimin e siguris dhe shendetit ne pune – kopje e noterizuar valide.**
		7. OE duhet te ofroj vleresimin e riskut nga nje kompani e licencuar nga MPMS , sipas Ligjit Nr.04L 161 per siguri dhe shendet ne pune .	**7. Deshmi kopja e certifikates per siguri dhe shendet ne pune e noterizuar nga origjinali per punetoret dhe inxhinjeret nen piken a,b,c,d,e te certifikuar per siguri dhe shendete ne pune si dhe kopja e licences se bashku me raportin e vleresimit nga kompania e licencuar nga MPMS-ja.**
		8. OE duhet te ofroj certifikaten ISO 14001 2015	**8. ISO 14001 2015 - sistemi per menaxhimin mjedisor - kopje e noterizuar valide**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papergjegjshem.

OE i rekomanduar për kontrate eshte i pergjegjshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Sqarim i lëndës

OE ankues pretendon se Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se gjate vlerësimit te ofertave duke e arsyetuar se ka shpallur te përgjegjshëm një operatore ekonomik i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kriteret e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

OE ankues ne ankesën e tij pretendon se:

Pretendimi 1. Ne qasjen e dokumentacionit te OE te rekomanduar per kontrate kemi verejten se i njejti e ka vertetimin e ATK me daten 29.06.2023 mirpo ne kerkesen per ri-shqyrtim Ak na ka ngarkuar vertetimin e ATK-se me daten 20.12.2023 qe eshte ne kundershtim me LPP-në

Ne kerkesen 3. Vertetimi per ATK dhe deshmite e kerkuara **2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës -kopje)**
Pika 1. OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar vertetimin e ATK-se me afat dy dite pas vendimit te AK-se i cili eshte ne kundershtim te ligjit mbi KRPP sepse eshte dashte se pari te siguroj vertetimin e ATK me afat pastaj ta shpalle fituesin e tenderit.
Vendimi i AK eshte shpallur me 18.12.2023 ndersa ATK e OE te rekomanduar per kontrate eshte me date 20.12.2023 qe do te thote eshte ne kundershtim te plote me ligjin.
Shih me poshte vendimin e AK-se.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lendes ka vërejtur një shkelje procedurale nga ana e autoriteti kontraktues, sepse vërtetimi i ATK-së i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate mban datën: 20.12.2023, ndërsa vendimi B58 për dhënie të kontratës mban datën: 18.12.2023.

Sipas dispozitave të nenit 25.9 të Rregullores për prokurim publik, këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së, e që ne rastin konkret AK-ja, i ka pranuar me datën 20.12.2023, dy dite pas publikimit të vendimit B58.

Eksperti shqyrtues lidhur me ketë çështje sqaron se kjo mund të konsiderohet si shkelje procedural nga ana e AK-së gjatë zhvillimit te procedurave te vlerësimit te ofertave dhe te mos ketë ndryshim ne rezultatin përfundimtar te përzgjedhjes së fituesit sepse behet fjale për një dokument i cili mund të kërkohet edhe pas dorëzimit te ofertave e qe ne ketë rast për te përmirësuar ketë shkelje procedurale AK-ja do ta kërkonte Brenda afatit te parapare ne nenin 25.9 të Rregullores, gjate fazës se rivlerësimit .

Mirëpo eksperti shqyrtues, gjate analizimit te dëshmive te dorëzuara me date: 20.12.2023, nga OE i rekomanduar për kontrate, ka vërejtur se i rekomanduari për kontrate ka borxhe ne ATK dhe përveç

vërtetimit te ATK-se i ka bashkangjitur edhe marrëveshjen e datës: 20.12.2023 e nënshkruar me ATK-ne, për shlyerjen e borxheve, te cilën e gjeni me poshtë.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

ATK-DMP 4015/23 20.12.2023

MARRËVESHJE PËR PAGESË TË BORXHEVE TATIMORE ME KËSTE

Marrëveshja Nr. 21408 Data: 20.12.2023
Administrata Tatimore e Kosovës, e përfaqësuar nga Udhëheqesi i Divizionit:.....
Dhe **R & Rukolli** (Tatimpaguesi) me NF: 8 1 0 6 1 8 3 6 6
Adresa: **"18 QERSHORI"**

Lidhë Marrëveshje Pagese për të paguar borxhet me këste, sipas Rastit të Mbledhjes Nr. **16204 / 20.12.2023**

Eksperti shqyrtues vlerëson se marrëveshja e prezantuar me lart është ne kundërshtim me interpretimin nr. 6 te KRPP-se, te datës: 22.11.2022, sepse sipas këtij interpretimi marrëveshja ne fjale është valide vetëm ne rast se marrëveshjet për shlyerjen e borxheve duhet te jenë para datës se publikimit te njoftimit për kontrate.

Ne rastin konkret për aktivitetin e prokurimit ne fjale dorëzimi/hapja e ofertave është bere me datën: 23.11.2023, ndërsa vërtetimi i ATK-se dhe marrëveshja e nënshkruar nga OE i rekomanduar për kontrate me ATK-ne mban datën: 20.12.2023. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligji Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 "aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;" Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi "aktualisht" nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosje e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesu për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë "të pranueshëm" për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë "të pranueshëm" kur ata ofrojnë bashku me tenderin e tyre dëshminë "Deklaratën nën betim" me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "i pranueshëm" OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërteto se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, **KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës.** Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Florije Rexhepi